# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: KOMUNA E MAMUSHËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **626-23-7240-2-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Sa i përket tenderit për

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

| | |
|---|---|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | **Zeqir M. Krasniqi B.I.** |
| NUI | **810634198** |
| Adresa | **Rruga Hajdin Berisha Pn.** |
| Vendi | **Suhareke** |
| Kodi postar | **23000** |
| Numri Telefonit | **049593002** |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | **Bashkim Krasniqi** |
| Adresa elektronike | |
| Data e parashtrimit të kërkesës | **08.03.2024** |

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-i

Adresa elektronike t

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

**SERVISIMI, MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË SË MAMUSHËS**

**Ku aktivitet eshte Anuluar nga AK Komuna Mamashu pas vendimit te OSHP-se i cili e ka aprovuar ankesen tone dhe e ka kthyer lenden ne rivleresim.**

**OSHP-së nr. OSHP: 2023/0676 të datës: 18.12.2023.**

**Me date 07.03.2024, AK duke vepruar ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se na ka eleminuar per dy aresye:**

**1.Nuk kemi plotesuar nje pozicion te cmimeve te cilin vete e ka plotesuar me N/A**

**2.Per nje kerkese e cila tashme e sqaruar**

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** ☐ **Jo** ☒

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 Qëllimi
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Me datë: 07.03.2024, pa një procesi maratonik të vlerësimit dhe në kundërshtim me të gjitha afatet kohore të përcaktuara në LPP në nenin 59, AK ka publikuar vendimin me të cilin ka anuluar procedurën e prokurimit duke dhënë arësyeshmërine së asnjëri nga OE nuk ka përmbushur kërkesat e FDT-së.

Fillimishtë RIVLERËSIMI është bërë duke mos respektuar Vendimin e OSHP-së nr. OSHP: 2023/0676 të datës: 18.12.2023.

AK Komuna Mamushë, ne Letrën standarde të datës 07.03.2024, me të cilën na ka eleminuar neve si OE ka bërë dy shkelje të LPP-së:

1.Në arësyen e I-rë thotë që ne jemi eleminuar sepse në përshkrim të cmimeve pjesa B, pozicioni nr.219 nuk kemi venmdosur çmim për Veruën TOYOTA Raë 4x4. Kjo nuk qendron fare sepse në këtë pozicion vetë ju si AK keni vendosur N/A, dhe në të njëjtin vendim keni cekur që pozicionet të cilat janë shënuar me N/A nuk keni nevojë me vendosë çmime. Pra ju qëllimishte na keni eleminuar për një pozicion për të cilin keni thënë mos vendos çmime (N/A) shiko FOTON:

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 217 | Relej e [illegible] | copë | 1 | €2.00 | €2.00 | €3.00 | €3.00 | €2.00 | €3.00 | €3.00 | €3.00 | €3.00 | €3.00 | €3.00 | €3.00 | €0.01 | €0.01 | €10.00 |
| 218 | Kontrollues i ventilatorëve | copë | 1 | €5.00 | €5.00 | €5.00 | €5.00 | N/A | €5.00 | N/A | N/A | N/A | €5.00 | €500 | €5.00 | €5.00 | €10.00 | €10.00 |
| 219 | Automat të [illegible] për [illegible] Automatik | copë | 1 | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | €3.00 |
| 220 | Matës i ujit | copë | 1 | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A |
| 221 | Regulator i gasit i Elektronik | copë | 1 | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A |
| | B - gjithsej: (1-220) | | | | | | | | | | | | | | | | | |

Ky eshte po
keni thene se
ka shenjen N/

Nëse ju si AK keni analizuar çmimoren apo përshkrimin e çmimeve konform nenit 59 i bjen që ne si AK jemi OE i përgjegjshëm dhe kemi plotësuar kërkesat e FDT-së dhe pasi kemi plotësuar këto kërkesa ju keni analizuar edhe përshkrimin e çmimeve. Pra keni vepruar me dy standarde dhe në kundërshtim me LPP-në, sepse nëse ne jemi të pa përgjegjshëm dhe nuk kemi plotësuar kërkesat e FDT-së që i keni cekur në arësyen nr.2, pse e keni analizuar përshkrimin e çmimeve dhe pse keni vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Edhe pse në arësyen e parë siq e cekëm më sipër nuk keni pasë të drejtë sepse ne kemi plotësuar të gjitha përshkrimet e çmimeve që nuk kanë pas shënjën N/A.

2.Sa i përket pretendimit tjetër dhe arësyes që na keni eleminuar për qështjen e autolarjes dhe hapësirës në shfrytëzim, ne ua rikujtojmë se këtë kërkesë të FDT-së e kemi plotësuar dhe ju kemi dhënë të gjitha sqarimet e duhura dhe për këtë qështje ka tashmë një proces gjyqësor dhe kërkojmë nga ju të mos bëheni pjesë e shtanazhit nga ana e nënshkruesve të marëveshjës.

Megjithatë po ju përgjigjemi në arësyen për kërkesën e FDT-së që ka të bëjë me autolarje, ku ju si AK keni kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të posedoj autolarje jo më larg se 5 (pesë) km nga teritori i
Mamushës ose mareveshje me ndonjë autolarje brenda distancës së kërkuar më lartë.

Sipas kërkesave të FDT-së ne kemi një PARAKONTRATË me DIMI shpk NIJAZI

GEGA B.I, ku jemi pajtuar që ne si NTSH KRASNIQI të marrim në shfrytëzim hapësirat e këtij biznesi për ti shfrytëzuar për autolarje siq ceket në dokumentin që e kemi dorëzuar me dosje.

Ne nuk kemi bërë kurrfar mashtrimi me këtë dokument sepse të nëjtin e ka nënshkruar DIMI SHPK dhe në këtë parakontratë ceket se: Palet merren vesh që në rast nënshkrimit të kontratës me AK Komuna MAMUSHË, do të përpilohet një aneks kontratë edhe të definohen dinamika e punimeve, oret shtese të shfrytëzimit të hapsirës dhe kostot.

Natyrishtë ky bashkëpuntor i jonë me presionin (e ndonjë OE, e tashmë po del që edhe ju jeni pjesë e këtij shantazhi), paska dërguar një njoftim për ju, e që neve nuk na ka informuar se dëshiron me e shkëput parakontratën.

Ajo që është e rendësishme është se ne nuk kemi bërë kurrfar falsifikimi, kurrfar mashtrimi, por përkundrazi jemi nën shantazh me dokumentin e dërguar DIMI SHPK, përmes juve. Ne kemi disa bashkëpunëtor në distancën e kërkuar nga ju me dosje dhe kemi mujte me ofru hapësira të tjera, por DIMI SHPK na ka ofruar bashkëpunim dhe e kemi bërë një parakontratë të cilën e kemi prezentuar në Dosje të tenderit.

Sidoqoft, për të ju dëshmuar juve, OSHP-së dhe të gjithë të interesuarve, që ne nuk kemi bërë asnjë falsifikim por parakontrata është lidhur me pajtimin dhe dijeninë e të dy palëve, ne kemi dorëzuar një padi për OE DIMI SHPK i cili përmes njoftimit të dërguar të ju është munduar me ndiku në procesin e vlerësimit dhe për më tepër ju e keni zyrtarizuar një qështje të tillë në një kohe kur lënda/procedura është e pezulluar.

Ky proces është duke vazhduar dhe nuhet të ndikoje në vlerësimin për këtë procedurë.

Konfirmojmë se me parakontratën e dorëzuar ne kemi plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, nëse ka ndryshuar situata gjatë procesit të vlerësimit, palët sigurisht do zgjidhin qështjën përmes organëve përkatëse dhe do të qartësohen interesat dhe shtytjet që i janë bërë DIMI SHPK për të dhënë një dekleratë të kundërt me atë që ka nënshkruar me ne para se të dorëzojmë ofertën tonë në AK Komuna Mamushë.

Ne ju sigurojmë që me ofërten tonë kemi plotësuar kërkesat e Dosjes së Tenderit, dhe nuk kemi bërë asnjë mashtrim në dokumentet e tenderit. Përkundrazi vlerësojmë se jemi duke u sulmuar nga forma të ndryshme, vetëm e vetëm për të mos na shpallur fitues të këtij projekti, por shresojmë se institucionet përkatëse do të japin përgjigjen e merituar për të gjitha PALËT.

Andaj edhe në arësyen e II-të që ju e keni dhënë për eleminin tonë, nuk qëndron

sepse ne kemi plotësuar kërkesat e FDT-së përfshirë kërkesën për hapësirën për autolarje.

Të bashkangjitur keni edhe njëher të gjitha sqarimet për qështjen e autlarjes përfshirë dëshmitë për padi që i kemi bërë OE DIMI shpk

Andaj kërkojmë që AK të aprovojë kërkesën për RISHQYRTIM , të kthejë lëndën në
RIVLERËSIM dhe të na shpall ne fitues si OE i përgjegjshëm me cmimin më të lirë.

**8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Ne si OE per nje periudhe te gjate punojne ne servisim te automjeteve dhe kemi disa kontata me AK, andaj ne rast se nuk trajtohemi te barabart nga AK perveq demeve financiare, na shkaktohen edhe deme morale**

**9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*